



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 Nr. 60/01-913/26
Kaçanik, 16.01.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja I (parë) e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 16 Janar 2026 (E Premte). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në Sallën e Komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Islam Gashi-LVV, Betim Shala-LDK, Lejla Luta-VZHK, Hafize Sallahi-AAK dhe Shemsedin Abazi-OJQ dhe Jeton Lika-OSCE.

Mbledhjen e udhëhoqi, Shemsedin Abazi (si anëtar i vjetër) deri në zgjedhjen e kryesuesit të Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtëse: Arianita Bajrami, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Shemsedin Abazi: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e I-të (parë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2026, data 16 janar, me këtë :

REND PUNE

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Komunitete,
2. Diskutim për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit askush, andaj rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua nga të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Komunitete,

Kryesues i Komitetit: Shemsedin Abazi:

Vijomë me pikën e parë të rendit të ditës e cila është zgjedhja e Kryesuesit për Komitetin për Komunitete. A ka dikush i/e cila dëshiron me e marrë fjalën?

znj.Hafize Sallahu: Duke qenë se përgjegjësia e kryesuesit është më e madhe se e anëtarëve të tjerë, edhe raporti ka rol të veçantë, sepse përmes tij dërgohen kërkesat/ankesat në Kuvend Komunal. E pasi që Betimi është i njohur me këto procese

unë mendoj që është i denjë për këtë post dhe e propozoj atë për Kryesues të këtij Komiteti!

z.Shemsedin Abazi: A ka dikush ndonjë propozim tjetër?

Pasi që nuk ka propozime të tjera, hedhim në votim propozimin e znj. Hafize Sallahu për Betim Shalën si Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Pra me shumicë votash (5/5) pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Betim Shala zgjidhet Kryesues i Komitetit për Komunitete dhe vijon udhëheqjen e mbledhjes.

2. Diskutim për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026;

z.Betim Shala: Hapi diskutimin lidhur me planin e punës së Komitetit për komunitete, nëse keni ndonjë propozim.

z. Jeton Lika: unë propozoj që përmes zyrës së Kuvendit të shqyrtohen planet e viteve të kaluara dhe të ndërthurën dhe të ndërtohet një plan i cili mund të përmbushet i tëri, dhe jo të mbesin pikat e papërmbushura.

z.Betim Shala: Problemi tek vitet e kaluara ka qenë se tek grupi i kaluar raportet kanë çaluar jashtë mase, jo se nuk kemi pasë aktivitete të mjaftueshme!

znj. Hafize Sallahu: Ne herave të kaluara në Komitetin për Komunitete kemi pasë të pranishëm edhe Drejtoritë Komunale, d.m.th. kemi pasë bashkëpunim por sërish siç tha Betimi nuk i kemi pasë të shënuara në raporte. Poashtu nuk jam e pajtimit që raportet të shënohen me gjysma (secili nga pak), por tërësisht nga Kryesuesi i Komitetit normalisht që me ndihmën tonë.

z.Betim Shala: Po për hartimin e planit si po e vendosim?

Znj. Hafize Sallahu: Duke qenë se plani është plan afatgjatë, mendoj se duhet të ndërtohet në mënyrë të detajuar dhe jo “shkel e shko”, andaj nëse jeni të pajtimit propozoj që të punohet në ndërkohë dhe të shqyrtohet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen tjetër.

z.Betim Shala:

A jeni të pajtimit që ta bëjmë gati planin për takimin tjetër?

Atëherë me shumicë votash (5/5) për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim hartimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete zhvendoset deri në mbledhjen tjetër.

3. Të ndryshme;

z.Betim Shala: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë po e shpall mbledhjen të përfunduar, në ora 11:40.

Procesmbajtës:
Arianita Bajrami

Kryesues i Komitetit:
Betim Shala

